



www.legjislacioni.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 15

Tiranë – E hënë, 5 tetor 2015

PËRMBAJTJA

| | Faqe |
|---|---|
| Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës nr. 2842, datë 10.2.2014 | Me objekt: Kërkesë për çeljen e procedurave të falimentimit për shoqërinë “Inter Gaz” sh.a..... 3 |



VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, e përbërë nga: kryetari i seancës gjyqësore, Petraq Çuri, asistuar nga sekretaria Diana Medani, në Durrës, në datën 10.2.2014, mori në shqyrtim me dyer të hapura çështjen civile që i përket palëve ndërgjyqëse:

KËRKUESE: Drejtoria Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhenj Tiranë, përfaqësuar nga Elvin Shllaku, në bazë të autorizimeve nr. 17243/1 prot. datë 18.10.2013 dhe nr. 18752/1 prot., datë 23.10.2013.

PERSON I TRETË: 1. Shoqëria “Inter Gaz” sh.a., me seli në Porto Romano, 500 metra në veri të Hidrovorit, godina 3-katëshe, në mungesë.

2. Qendra Kombëtare e Regjistrimit Tiranë, në mungesë.

ME OBJEKT: Kërkesë për çeljen e procedurave të falimentimit për shoqërinë “Inter Gaz” sh.a.

BAZA LIGJORE: Neni 104 i ligjit 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në RSH”, ligji nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”, të ndryshuar me ligjin 9919, datë 19.5.2008.

Gjykata, pasi shqyrtoi në tërësi çështjen dhe pasi administroi provat dhe aktet e ndodhura në dosje, dëgjoi përfaqësuesin e paditësit, i cili kërkoi pranimin e kërkesës; palën e tretë, shoqërinë “Inter Gaz” sh.a., në mungesë; palën e tretë, QKR Tiranë, në mungesë,

VËREN:

Pala kërkuese, Drejtoria Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhenj Tiranë, ka paraqitur kërkesë para gjykatës dhe me palë të tretë, shoqërinë “Inter Gaz” sh.a., me seli në Durrës, me objekt: Kërkesë për çeljen e procedurave të falimentimit për shoqërinë “Inter Gaz” sh.a.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin e saj nr. 7320, datë 27.6.2013, ka vendosur deklarinimin e moskompetencës tokësore të saj dhe dërgimin e çështjes për gjykim, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, si gjykatë kompetente.

Nga ana e gjykatës konstatohet se çështja hyn në juridiksionin gjyqësor dhe kompetente për gjykimin e saj është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës. Pala e tretë, shoqëria “Inter Gaz” sh.a.,

paraqiti si përfaqësues të saj z. Ralf Spiro me autorizimin e datës 23.9.2013, i cili ishte firmosur nga Frederik Bare.

Nga ekstrakti historik i kësaj shoqërie i dërguar nga QKR-ja Tiranë, të datës 19.6.2013, rezulton se drejtori i shoqërisë, Frederik Bare, ishte caktuar më datë 28.4.2009 dhe përfundonte detyrën në datën 28.4.2012.

Iu kërkua përfaqësuesit Ralf Spiro, të sillte ndryshimin e vendimit të aksionarëve, lidhur me drejtorin e shoqërisë, pasi Frederik Bare nuk kishte të drejtën e caktimit të përfaqësuesve në emër të shoqërisë, bazuar kjo dhe në nenin 18 dhe 19 të statutit të kësaj shoqërie. Nga ana e tij nuk u paraqit, për rrjedhojë gjykata vijoi në mungesë të palës së tretë.

Ligji 8901, datë 23.5.2002, në nenin 3, të tij shprehet:

“Realizimi i procedurave të falimentimit është detyrë e seksioneve të gjykatës së rrethit (Gjykata e Falimentit).

Nga analiza e kësaj dispozite përcaktohet se në kompetencë të gjykatave tregtare është edhe fillimi i procedurave të falimentit dhe se ajo përfshin në kompetencën e saj lëndore e tokësore ato shoqëri që përfshihen brenda rrethit përkatës ku ajo operon. Një parashikim i tillë përrputhet edhe me nenin 334/dh të KPC-së, në të cilin thuhet:

“Në kompetencë të seksioneve për gjykimin e mosmarrëveshjeve tregtare pranë gjykatave të shkallës së parë janë:.....

Dh) procedurat e falimentimit.”

Nga shqyrtimi i çështjes rezultoi se:

Pala kërkuese, Drejtoria Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhenj Tiranë, ka paraqitur kërkesë konform nenit 14 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”, në të cilin thuhet:

“1. Procedura e falimentimit hapet vetëm me kërkesën e debitorit ose të kreditorëve. Në rastin e personave juridikë, procedura e falimentimit mund të hapet edhe me kërkesën e organeve tatimore, ku rezulton një bilanc me humbje për një periudhë 3-vjeçare.”

Kjo dispozitë e ligjit, e cila duhet të respektohet nga pala kërkuese, pasi përbën dhe legjitimitetin e kësaj pale në këtë proces gjyqësor.

Pala kërkuese paraqiti para gjykatës bilancet e palës së paditur, shoqërisë “Inter Gaz” sh.a., për vitet 2009, 2010, 2011.



Gjithashtu pala e tretë, shoqëria “Inter Gaz” sh.a., ka një detyrim tatimor ndaj palës kërkuese në shumën prej 7.209.392 lekë.

Koncepti juridik i falimentimit, është realizimi i të drejtave të kreditorëve ndaj shoqërisë debitore. Në rastin e detyrimeve ndaj palës paditëse, Drejtorisë Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhenj, është krijimi i mundësive financiare, në pasurinë e palës debitore për shlyerjen e detyrimeve ndaj shtetit, i cili përfaqësohet nga pala kërkuese.

Për të filluar një procedurë falimentimi, duhet që nga ana e palës kërkuese të jetë hetuar lidhur me pasurinë e palës së tretë “Inter Gaz” sh.a., në ato subjekte, të cilat administrojnë pasuritë financiare ose pronat e palës së tretë.

Pala kërkuese nuk ka mundësitë reale për të hetuar lidhur më gjendjen pasurore të palës së tretë, mbasi organet financiare private, nuk i përgjigjen asaj lidhur me këto kërkime.

Atëherë është detyrë e gjykatës të hetojë, për këtë, gjykata kërkoi nga bankat të cilat operojnë në rrethin e Durrësit, lidhur me gjendjen financiare të palës së tretë, dhe konkretisht, në këto banka:

1. UNION BANK;
2. Banka Procredit;
3. NBG Bank
4. Raiffeissen Bank;
5. BKT Bank;
6. Emporiki Bank;
7. Banka Ndërkombëtare Tregtare;
8. Fibanka;
9. Intesa Sanpaolo Bank;
10. Veneto Banka;
11. Banka Credins;
12. UBA;
13. Societe Generale Bank.

Gjithashtu ZVRPP Durrës, me shkresën e saj nr. 487/1 prot., datë 31.1.2014, njofton se pala e tretë, shoqëria “Inter Gaz” sh.a., ka pasuri të regjistruara pranë asaj zyre dhe konkretisht pasurinë me nr. 66/14, ZK 3184, truall me sipërfaqe 27683 m² dhe sipërfaqe ndërtimore 4422m².

Kurse Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor Durrës, me shkresën 449/1 prot., datë 3.2.2014, njofton se pala e tretë nuk ka në pronësi të saj mjete transporti.

Neni 1 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, shprehet:

“1. Procedura e falimentimit ka qëllim të shlyejë në mënyrë kolektive, detyrimet e debitorit nëpërmjet likuidimit të të gjitha pasurive të tij dhe shpërndarjes së të ardhurave, ose në rastin e një plani riorganizimi, nëpërmjet arritjes së një marrëveshjeje tjetër, me synim kryesor ruajtjen e veprimtarisë së tij.

2. Çdo debitori të ndershëm, nëpërmjet procedurës së falimentimit, i jepet mundësia të shkarkohet nga pjesa e mbetur e detyrimeve.”

Po kështu neni 13 i ligjit të mësipërm, përcakton se:

“1. Procedura e falimentimit hapet vetëm me shkak.”

Si shkaqe të fillimit të procedurave të falimentit, janë pikat 2, 3, 4, 5 të këtij neni, ku krahas paaftësisë paguese të debitorit, pamundësinë e tij për të paguar borxhet ose detyrimet e ardhshme janë dhe detyrimet e tij të papaguara.

Në rastin konkret rezulton se pala e tretë, shoqëria “Inter Gaz” sh.a., ka një detyrim ndaj palës kërkuese në masën 7.209.392 lekë.

Pra në rastin konkret, pala kërkuese legjitimohet në ngritjen e kësaj kërkese, jo vetëm për shkak se shoqëria “Inter Gaz” sh.a. ka dalë me humbje për tre vjet rresht, por edhe për faktin se ajo është debitore ndaj palës kërkuese.

Neni 18 i ligjit 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, shprehet:

“Shqyrtimi i çështjes dhe dhënia e vendimit për hapjen e procedurës së falimentimit.”

.....

4. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit brenda afateve të treguara në pikën 3 të këtij neni, vendos:

.....

c) pranimin e kërkesës dhe hapjen e procedurës së falimentimit.”

Gjykata konstaton se në pronësi të palës së tretë, shoqërisë “Inter Gaz” sh.a., ka në pronësi të saj pasurinë me nr. 66/14, ZK 3184, truall me sipërfaqe 27683 m² dhe sipërfaqe ndërtimore 4422 m².

Në këtë rast gjykata do të vendosë edhe sekuestron konservative të kësaj pasurie, si garanci për ekzekutimin e këtij vendimi, shlyerjen e detyrimit të palës debitore ndaj palës kreditore konform nenit 21 të ligjit.



Gjykata, duke pranuar kërkesën e palës kërkuese për hapjen e procedurave të falimentit, do të respektojë të gjitha përcaktimet e bëra në nenin 26, 27 dhe 29 të ligjit “Për falimentimin”.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata, pasi pa dhe nenet 31, 32, 310, të KPC-së, ligjin nr. 8901, datë 13.5.2002, “Për falimentimin”,

VENDOSI:

Pranimin e kërkesës së palës kërkuese, Drejtorisë Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhenj Tiranë.

Hapjen e procedurës së falimentimit për palën e tretë, shoqërinë “Inter Gaz” sh.a., me seli në Durrës, Porto Romano, 500 metra në veri të Hidrovorit, godina 3-katëshe, me objekt veprimtarie, tregti me shumicë e pakicë të gazit, naftës dhe nënprodukteve të tyre, përpunim, prodhim të nënprodukteve të gazit, ambalazhimit të tyre me shumicë e pakicë.

Të caktojë si administrator të falimentit z. Robert Begaj, lindur në Vorë e banues në Tiranë, rr. “Medar Shtylla”, 48/1.

Hapja e procedurës së falimentit u krye në ora 13 e 30’ të datës 10.2.2014.

Vendosjen e sekuestros konservative mbi pasurinë me nr. 66/14, ZK 3184, truall me sipërfaqe 27683 m² dhe sipërfaqe ndërtimore 4422 m².

Pala kërkuese, Drejtoria Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhenj, duhet të paraqesë te administratori i falimentit pretendimet e tyre me shkrim, si dhe bashkëngjitur dokumentacionin përkatës.

Afati i paraqitjes së pretendimeve nga pala kreditore nuk mund të jetë jo më pak se 15 ditë dhe jo më shumë se 90 ditë nga data e këtij vendimi.

Pala e tretë debitore, shoqëria “Inter Gaz” sh.a., duhet që detyrimet e saj t’ia paguajë administratorit të falimentit.

Ky vendim duhet t’i komunikohet palës kërkuese, palës së tretë dhe QKR-së Tiranë.

Urdhërohet QKR Tiranë të publikojë këtë vendim në internet, në faqen zyrtare të saj.

Një kopje e këtij vendimi t’i dërgohet ZVRPP-së Durrës, Drejtorisë Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhenj Tiranë, Drejtorisë Tatimore Durrës.

Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.

Kundër vendimit lejohet ankimi i veçantë, brenda 5 ditëve në Gjykatën e Apelit Durrës. Për palën në mungesë, afati fillon nga dita e nesërme e ditës së komunikimit të vendimit.

Durrës, më 10.2.2014

GJYQTARI
Petraç Çuri

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.